



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

### Nr. 34

Datë: 16. 04. 2021. Ora: 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Eshref Vishi, kryesues i mbledhjes së KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

#### **1. Hyrje: z. Eshref Vishi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së KQZ-së Nr.29,30,31,32 dhe 33/2021.

#### **2. Aktivitetet e SKQZ-së:**

#### **3. Aktivitetet e ZRPP-së:**

#### **4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

##### **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Ferizaj, Prishtinë dhe Istog.

### **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për refundim të depozitave të subjekteve politike që kanë fituar së paku një(1) vend në zgjedhjet parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- Shqyrtimi dhe miratimi për transferimin e depozitave në Buxhetin e Kosovës të pagesave të certifikimit që nuk i refundohen subjekteve politike.

### **5. Të ndryshme**

---

#### **1. Hyrje: z. Eshref Vishi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Eshref Vishi:** Në bazë të autorizimit të kryetares së KQZ-së, këtë takim do ta kryesoj unë. E keni rendin e ditës, a pajtoheni ? Miratohet rendi i ditës.

Në vazhdim të mbledhjes, miratohen procesverbalet nga mbledhjet e KQZ-së nr. 29,30,31,32 dhe 33/2021, me disa vërejtje dhe sugjerime në lidhje me formatin e procesverbaleve.

#### **2. Aktivitetet e SKQZ-së:**

**Burim Ahmetaj:** Sekretariati është në procesin e hartimit të raportit të punës së KQZ-së për vitin 2020. Procesi është në fund të këtij dokumenti, pra duke u kompletuar. Në fund të muajit prill, dokumenti shkon në Kuvendin e Kosovës, sikur edhe në të kaluarën. Konsiderojmë që jemi në afat të draftimit, dhe së shpejti do ta sjellim në KQZ për shqyrtim.

Sekretariati ju njofton se materiali është kthyer në QNR. Ka më pak material për shkak të riciklimit të materialit 2007, 09, dhe 2019, dhe jemi në proces të hartimit të specifikave të fletëvotimit 2021. Pra, përmes ankandit do ti riciklojmë materialit që të mund të shiten, ne këtë formë ne nuk e kemi praktikuar.

Aktivitet tjetër, është formua komisioni për identifikimit të materialeve që do të shiten për hekur në ankand publik, dhe një komision tjetër është formuar për asgjësimin e UV Spreit i cili, është grumbulluar nga viti 2013, e që janë jashtë përdorimit. Ne, do ta identifikojmë sasinë, dhe do ti marrim nga Ministria e Planifikimit Hapësinorë udhëzimet e shkatërrimit të këtij materiali.

Po ashtu, kemi formuar edhe një komision për identifikimin e të gjithë artikujve që i kemi përdorur nga viti 2013 dhe që për KQZ-në janë jashtë përdorimit. Fjala është për tabletat që i kemi përdorur për

rezultatet preliminare, dhe për shkak të aspektit kohorë ( sepse vitin e kaluar i kemi blerë të rejtat) janë jashtë përdorimit. Edhe pse punojnë, rekomandimi i komisionit është që këto pajisje të jepen si donacion...

**Alim Rama:** Kërkoj edhe njëherë që për shkak të efektetit të UVsprejtit që, ky material të mos derdhet në natyrë, por të asgjësohen në mënyrë profesionale. Pra, këto materiale të mos shkaktojnë ndotje të ambientit, por të shkatërrohen në koordinim për shkak të përmbajtjeve...Sa u përket tableteve, sic e kuptova këto nuk i plotësojnë kushtet për softverin e tanishëm, por ne nuk mundemi me i shkatërrua materialet që punojnë por ato që nuk i plotësojnë kushtet ! Tjetra, ndoshta sa i përket operimit me stafin esencial, unë dje nuk gjeta shofer...Të caktohet një procedurë, dhe shërbimet megjithatë të jenë funksionale...

**Burim Ahmetaj:** Po uvsprejat e vitit 2013, janë vendosur në tokë në Mitrovicë, nuk e di saktë lokacionin por, ne do të jemi në koordinim me institucionit dhe ta shohim mundësinë...! Sa u përket tabletave, ato tani janë jashtë përdorimit por, mund të shërbejnë për institucionet e tjera...

Çështja e shoferit, është një angazhim yni permanent dhe, sigurisht do të marrim masa...

Në këtë pikë, sidomos rreth procesit dhe kohës së përfundimit të materialit që tash është për riciklim, për mënjanim dhe jashtë përdorimit, shtroi pyetje edhe Eshref Vishi. Në detaje, dhe sqarime kryeshefi, Burima Ahmetaj.

### **3. Aktivitetet e ZRPP-së:**

**Yll Buleshkaj:** E kemi realizue nënshkrimin lidhur me marrëveshjen me të gjitha partitë që kanë sigurue ulëse në Kuvendin e Kosovës, në mënyrë që të sigurohet sasia e fondeve të përkrahjes që u takojnë atyre. Së dyti, jemi takuar me Komisionin e Kuvendit për Fiananca Publike në lidhje me atë se ku jemi me procedurat e tenderimit e shërbimit për Auditim, sepse në zyre na janë bërë shumë materiale qe tri vite... Komisioni, na ka informuar se shumë shpejt do të fillojë procedura e tenderimit, dhe zyrës i janë kukuar disa materiale: raportet dhe çështjet e tjera që lidhen me këtë procedurë...

S'i pikë e tretë, kemi marrë një aplikim të një subjekti të ri, dhe zyra është në vazhdim të procedurave...

### **4. Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për refundim të depozitave të subjekteve politike që kanë fituar së paku një(1) vend në zgjedhjet parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës:

**Sami Hamiti:** Në takimin e fundit, kemi shqyrtuar rekomandimin e refundimit të depozitave të subjekteve politike që kanë fituar së paku një(1) vend në zgjedhjet parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne, këtë e kemi konsideruar si pjesë formale sepse e përcakton ligji, dhe mbasi që nga MEF-i kërkohet një vendim ne rekomandojmë që të aprovohet.

Po ashtu, në mbledhje kemi shqyrtuar edhe transferimin e depozitave në Buxhetin e Kosovës të pagesave të certifikimit që nuk i refundohen subjekteve politike. Bëhet fjalë për 12 subjekteve...

Të dy këto rekomandime, u aprovuan unanimisht.

#### **5.Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

##### **Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Ferizaj, Prishtinë dhe Istog:

**Arianit Elshani:** Në mbledhjen e këshillit, kemi shqyrtuar tri kërkesa për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Ferizaj, Prishtinë dhe Istog. Meqenëse të tri kërkesat kanë kaluar filtrat ligjorë, duke marrë për bazë edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ne rekomandojmë zëvendësimet...

**Eshref Vishi:** Kush është për që Vjollca Rizani, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Prishtinë nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Vlora Dumoshi.

Miratohet.

**Eshref Vishi:** Kush është për që z. Flamur Istrefi të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Ekrem Mustafa.

Miratohet.

**Eshref Vishi:** Kush është për që z. Astrit Bujupaj, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Istog nga subjekti politik Inisiative Qytetare e Pavarur e Istogut, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Arif Elshani.

Miratohet.

**6.Të ndryshme !**